



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË
KOORDINATOR I KONSULTIMIT PUBLIK

Nr. 3002 / Prot.

Patos, më 07 / 11 / 2025

PROCESVERBALI I TAKIMIT 5 NËNTOR 2025

Vendi: Salla e Këshillit Bashkiak Patos

Ora e fillimit: 10:30

Ora e mbarimit: 11:30

Dëgjese publike me temë: “Vlerësimi strategjik mjedisor mbi Planin Lokal të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve 2025-2030”.

Baza Ligjore: Në zbatim nenit 18 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjit nr. 146/2012 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, Rregullores së Këshillit Bashkiak “Për konsultimin publik”, si dhe kërkesës së Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik, Taksave, Mjedisit dhe Turizmit me nr. 2896 prot., datë 23.09.2025.

Pjesëmarrës: Kryetar i bashkisë z. Fation Duro, Kryetar i Këshillit z. Armand Ahmetaj, Deputete e zonës znj. Antoneta Dhima, përfaqësues të bashkisë Patos, rreth 35 pjesëmarrës (banorë, kryetarë të fshatrave, përfaqësues nga shoqëria civile etj)

Takimin hapet nga Kryetar i Këshillit z. Armand Ahmetaj

Kryetar i Këshillit z. Armand Ahmetaj- të nderuar të pranishëm! Ju falenderoj që jeni bërë



**Kryetar i Këshillit
z. Armand Ahmetaj**

**Dëgjese publike me temë:
“Vlerësimi strategjik mjedisor mbi Planin
Lokal të Menaxhimit të Integruar të
Mbetjeve 2025-2030”
Nëntor 2025**

pjesë të kësaj dëgjese publike. Në zbatim nenit 18 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen

vendore” i ndryshuar, ligjit nr. 146/2012 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, Rregullores së Këshillit Bashkiak “Për konsultimin publik”, si dhe kërkesës nr. 2896 prot., datë 23.09.2025, jemi këtu sot për të prezantuar dhe diskutuar mbi materialin e përgatitur nga ekzekutivi lidhur mbi Vlerësimin Strategjik Mjedisor mbi Planin e Mbetjeve 2025-2030 të bashkisë. Ftoj të ndiqni prezantimin dhe më pas mund të drejtoheni me rekomandime dhe sugjerime lidhur me këtë dokument.

Drejtore i Zhvillimit Ekonomik, Taksave, Mjedisit dhe Turizmit, z. Çajup Refitaj – përshëndetje të gjithëve! Jemi këtu për të prezantuar materialin lidhur me Vlerësimin



**Drejtore
z. Çajup Refitaj**

Dëgjese publike me temë:

**“Vlerësimi strategjik mjedisor mbi Planin
Lokal të Menaxhimit të Integruar të
Mbetjeve 2025-2030”**

Nëntor 2025

Strategjik Mjedisor ose i quajtur shkurt VSM. Qëllimi i këtij Vlerësimi Strategjik Mjedisor është të paraqesë informacion rreth PLMIM, të identifikojë, përshkruaj dhe të vlerësoj efektet kryesore të mundshme të PLMIM dhe alternativat e tjera të arsyeshme, t’u japë mundësi konkrete dhe në kohë autoriteteve të konsultimeve dhe publikut për të paraqitur opinionet e tyre rreth çdo aspekti të vlerësimit mjedisor. Ky Vlerësim Strategjik Mjedisor ka për qëllim të vlerësojë ndikimet mjedisore të Planit Lokal të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve për Bashkinë Patos, duke siguruar që zhvillimi i politikave dhe veprimeve të parashikuara të jenë në përputhje me parimet e zhvillimit të qëndrueshëm dhe mbrojtës së mjedisit. Plani Lokal i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve të Ngurta Urbane për Bashkinë Patos është një dokument strategjik i domosdoshëm që mundëson zbatimin në nivel lokal të politikave kombëtare për menaxhimin e mbetjeve, duke shërbyer si udhëzues praktik për përmirësimin e sistemit të menaxhimit të mbetjeve urbane në territorin e bashkisë. Ky plan ofron një orientim të qartë strategjik për të ardhmen dhe synon të krijojë një qëndrim të përbashkët ndërmjet të gjithë aktorëve lokalë për të përmirësuar performancën në sektorin e menaxhimit të mbetjeve. PLMIM përqendrohet në veprime konkrete dhe të detajuara që lidhen me grumbullimin, trajtimin dhe riciklimin e mbetjeve, trajtimin final dhe menaxhimin e impianteve të dedikuara për mbetjet. Qëllimi i këtij plani është të përballojë sfidat e reja që ka Bashkia Patos për të siguruar ofrimin e shërbimeve të pastra, efikase dhe të qëndrueshme të menaxhimit të

mbetjeve në të gjithë territorin e saj, duke harmonizuar interesat e komunitetit dhe institucioneve publike, duke optimizuar koston e shërbimeve në përputhje me buxhetet e kufizuara vendore. Bashkia Patos përbëhet nga 3 njësi administrative, 1 qytet dhe 18 fshatra. Territori i bashkisë së Patosit shtrihet pjesërisht mbi zonën naftëmbajtëse Patos-Marinëz, e cila përbën një burim natyror të rëndësishëm dhe potencial për zhvillimin ekonomik. Sektorët që ofrojnë punësim për banorët e zonës janë industria e nxjerrjes së naftës, sektori i ndërtimit, bujqësia, blegtoaria dhe pemëtaria. Bashkia e re shtrihet në një sipërfaqe prej 82.5 km² me një densitet prej 510.37 banorë/km² sipas Regjistrisë Civile. Meqenëse aktualisht nuk ka një sistem monitorimi sasitë e mbetjeve që prodhohen dhe grumbullohen janë përlllogaritur sipas sasisë së mbetjeve të depozituar në pikën e trajtimit të mbetjeve incinerator Fier. Gjatë vitit 2024 janë grumbulluar dhe transportuar 3848,19 ton mbetje urbane. Shërbimi i menaxhimit të mbetjeve kryhet nga Agjencia e Shërbimeve Publike (ASHP) në varësi të Bashkisë Patos. Referuar të dhënave të ASHP për sasinë e mbetjeve të dorëzuara në pikën përfundimtare të trajtimit të mbetjeve, gjatë vitit 2024 janë grumbulluar dhe transportuar 3848,19 ton mbetje urbane. Norma e gjenerimit të mbetjeve në zonën urbane është përafërsisht 0.7 kg/banorë/ditë ndërsa për zonën rurale nga 0.4 kg/banorë/ditë në 0,7 kg/banorë/ditë. Në zonën urbane, në një pjesë të Njësisë Administrative Ruzhdië si dhe në rrugët kryesore ku infrastruktura është e përshtatshme në Njësinë Administrative Zharrëz, grumbullimi i mbetjeve bëhet në kontener 1.1 m³. Largimi i mbetjeve drejt incineratorit bëhet nga ASHP me anë të mjeteve teknologjike. Në Njësinë Administrative Zharrëz kryhet dhe grumbullimi i mbetjeve “derë më derë”, për largimin e të cilave përdoren mjete vetëshkarkuese. Agjencia e Shërbimeve Publike kryen shërbimin e menaxhimit të mbetjeve (grumbullim dhe transport) gjatë 7 ditëve të javës në qytet dhe në Njësinë administrative Zharrëz ndërsa në Njësinë administrative Ruzhdië është 2 herë në javë. Ndikimet kryesore të mundshme mjedisore nga Plani Lokal I Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve nëse nuk merren masa për zbutjen e tyre duhet të identifikohen dhe të vlerësohen nga VSM. Këto efekte përfshijnë efektet pozitive dhe negative, efektet afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë, të përhershëm dhe të përkohshëm si dhe efektet kumulative. Si pjesë e përgatitjes së PLMIM, bashkia Patos është duke kryer një Vlerësim Strategjik Mjedisor për të shqyrtuar efektet e tij të mundshme mjedisore. Kjo VSM synon: - Të integrojë faktorët mjedisorë në përgatitjen e PLMIM. - Të përmirësojë PLMIM dhe të rrisë mbrojtjen mjedisore. - Të rrisë pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrje dhe - Ta bëjë vendimmarrjen më të hapur dhe më transparente. Qëllimi i këtij Vlerësimi Strategjik Mjedisor është: -Të paraqesë informacion rreth PLMIM. -Të identifikojë, përshkruajë dhe të vlerësojë efektet kryesore të mundshme të PLMIM dhe alternativat e tjera të arsyeshme. -T'u

japë mundësi konkrete dhe në kohë Autoriteteve të konsultimeve dhe publikut për të paraqitur opinionet e tyre rreth çdo aspekti të vlerësimit mjedisor. Plan i Lokal i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve për Bashkinë Patos është një dokument strategjik i domosdoshëm që mundëson zbatimin në nivel lokal të politikave kombëtare për menaxhimin e mbetjeve, duke shërbyer si udhëzues praktik për përmirësimin e sistemit të menaxhimit të mbetjeve urbane në territorin e bashkisë. Ky plan ofron një orientim të qartë strategjik për të ardhmen dhe synon të krijojë një qëndrim të përbashkët ndërmjet të gjithë aktorëve lokalë për të përmirësuar performancën në sektorin e menaxhimit të mbetjeve. PLMIM përqendrohet në veprime konkrete dhe të detajuara që lidhen me: Grumbullimin, Trajtimin dhe riciklimin e mbetjeve, Trajtimin final dhe menaxhimin e impianteve të dedikuara për mbetjet. Qëllimi i këtij plani është të përballojë sfidat e reja që ka Bashkia Patos për të siguruar ofrimin e shërbimeve të pastra, efikase dhe të qëndrueshme të menaxhimit të mbetjeve në të gjithë territorin e saj, duke harmonizuar interesat e komunitetit dhe institucioneve publike, duke optimizuar koston e shërbimeve në përputhje me buxhetet e kufizuara vendore. Plan i parashikon vlerësimin e alternativave më të mira të menaxhimit të mbetjeve, përcaktimin e nevojave për investime kapitale, si dhe vendosjen e një metodologjie të qartë për zbatimin, monitorimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit. “Çdo njësi e qeverisjes vendore harton planin vendor të menaxhimit të integruar të mbetjeve për territorin që ka nën juridiksion, në përputhje me Planin Kombëtar dhe Planin Rajonal të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve”. Menaxhimi i mbetjeve në bashkinë Patos, ashtu si në shumë bashki të tjera, përballlet me sfida të shumta si rritja e vazhdueshme e sasisë së mbetjeve, mungesa e sistemit të ndarjes në burim, praninë e deponive të pakontrolluara, dhe ndikimi i tyre në mjedis dhe shëndetin publik. Në Dokumentin e Politikave Strategjike dhe Planin Kombëtar për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve (Miratuar Maj 2020) është prezantuar një metodologji mbi bazën e prioriteteve të bashkisë për menaxhimin e mbetjeve, për të përcaktuar se cili do të konsiderohet standardi minimal për shërbimin e menaxhimit të mbetjeve. Bashkia Patos gjatë 6 vjeçarit të zbatimit të planit lokal për menaxhimin e mbetjeve kërkon mbi të gjitha të konsolidojë shërbimin në zonat ku aktualisht e ofron këtë shërbim, duke rritur gradualisht cilësinë e shërbimit të grumbullimit dhe transportit të mbetjeve dhe ta shtrijë atë në zonat ku aktualisht nuk e ofron shërbimin, kryesisht në zonat rurale: 1. Konsolidimi i shërbimit dhe mbulimi 100% i pjesës urbane të bashkisë gjatë periudhës 2025 – 2030. 2. Ngritja dhe forcimi i sistemit të ndarjes së mbetjeve në burim. 3. Zgjerimi i shërbimit nga 85% në 100% gjatë periudhës 2025– 2030. 4. Rritja e mbulimit të kostos operacionale me 10% çdo vit, gjatë periudhës 2025-2030. 5. Përmirësimi i mbledhjes së tarifës dhe efikasitetit financiar të

shërbimit. 6. Reduktimi i ndotjes mjedisore dhe mbrojtja e burimeve natyrore. 7. Zhvillimi i bashkëpunimeve me shkolla, komunitetin dhe bizneset për edukim mjedisor. 8. Përfshirja e inovacionit dhe teknologjisë në menaxhimin e mbetjeve. 9. Të promovojmë një ekonomi qarkore në nivel lokal duke reduktuar mbetjet, rritur riciklimin dhe ripërdorimin e materialeve si dhe duke krijuar mundësi të reja ekonomike përmes valorizimit të mbetjeve dhe përfshirjes së komunitetit dhe bizneseve në praktika të qëndrueshme. Menaxhimi i mbetjeve të ngurta bashkiake në Shqipëri bazohet kryesisht në detyrimet që burojnë nga synimet dhe afatet kohore të përcaktuara nga direktivat e Bashkimit European, si pjesë e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (MSA). Këto udhëzime lidhen gjithashtu me objektivat e Strategjisë Kombëtare për Menaxhimin e Mbetjeve. Drafti i Strategjisë Kombëtare për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve dhe Plani i saj i Veprimit (SKMIM – draft) është përgatitur nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, e cila aktualisht po finalizon dokumentin për miratim me Vendim të Këshillit të Ministrave (VKM). MSA përcakton aspiratën e Shqipërisë për t'u integruar në BE, duke vendosur objektiva afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata për përmirësimin e menaxhimit të mbetjeve. Përbushja e këtyre objektivave matet përmes raporteve periodike ndaj institucioneve të BE-së. Këto qëllime janë të integruara në dokumente të tjera strategjike, si Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI) 2014–2020 dhe Draft Strategjia Ndërsektoriale e Mjedisit (2015–2020). Bashkia e re e Patosit është krijuar nga bashkimi në një administrim të vetëm, të ish bashkisë së Patosit dhe 2 komunave, respektivisht Ruzhdie dhe Zharrëz. Bashkia Patos është pjesë e qarkut Fier 17 dhe përbëhet nga 3 njësi administrative: Patos, Zharrëz dhe Ruzhdie. Bashkia e re administron qytetin e Patosit dhe 18 fshatra. Bashkia Patos (pas ndarjes së re territoriale) ka një sipërfaqe totale prej 82.5 km² dhe kufizohet nga bashkitë Fier, Roskovec dhe Mallakastër. VSM duhet të identifikojë dhe të vlerësojë ndikimet dhe efektet mjedisore kryesore të mundshme të PLMIM, nëse nuk merren masa për zbutjen e tyre. Efektet përfshijnë ndër të tjera efektet pozitive dhe negative, efektet afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë, të përhershëm dhe të përkohshëm dhe efektet kumulative. Gjithashtu duhet të merren parasysh efektet e ndërtimit dhe ato operacionale. Kërkesa bazë për kryerjen e një VSM është paraqitja e detajeve të mjaftueshme rreth kuadrit metodologjik të propozuar për vlerësimin e efekteve mjedisore që mundëson krijimin e një pikëpamjeje rreth kësaj çështjeje. Propozohet që vlerësimi të drejtohet nga objektivat, në mënyrë që për secilën fushë të identifikuar të jetë i mundur vlerësimi kundrejt objektivave mjedisor të përcaktara të VSM.

Nëse nuk zbatohet PLMIM, zhvillimi i mjedisit në Bashkinë Patos mund të ndjekë një skenar negativ me rritje të ndotjes, humbje të vlerave të peizazhit dhe ndikime serioze mbi shëndetin

publik. Kjo do të sillte një përhapje më të madhe të pikave të paligjshme të depozitimit, shtim të rrezikut të ndotjes së ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore, dëmtime të mëtejshme të tokave bujqësore. PLMIM për Bashkinë Patos do të udhëhiqet nga objektivat kombëtare për menaxhimin e integruar të mbetjeve, duke përfshirë propozimin e kushteve teknike dhe zonave të përshtatshme për instalimin e teknologjive më efektive për grumbullim, riciklim dhe trajtim të mbetjeve, përcaktimin e koncepteve bazë për ndërtimin e infrastrukturës vendore për menaxhimin e mbetjeve urbane, inerte dhe industriale, respektimin e standardeve kombëtare dhe europiane për trajtimin e mbetjeve. Në fokus të veçantë do të jenë mbetjet e biodegradueshme dhe mbetjet e ambalazheve, duke u synuar reduktimi i tyre në burim dhe rritja e përqindjes së riciklimit. Norma mesatare e grumbullimit të mbetjeve në territrin e bashkisë Patos është 75,8 % veçanërisht në zonat rurale kjo normë është e ulët 60 % për shkak të infrastrukturës së kufizuar. Rekomandohet:

- Vendorsja e sistemit elektronik për monitorimin e mbetjeve.
- Rritja e frekuencës së grumbullimit në zonat rurale.
- Edukimi i komunitetit për ndarjen e mbetjeve dhe riciklimin.

Bazuar në karakteristikat urbane dhe rurale të territorit, në Bashkinë Patos gjenerohen këto rryma kryesore të mbetjeve:

1. Mbetje urbane të përziera (Të prodhuara nga familjarët, institucionet dhe tregtia).
2. Mbetje të riciklueshme (Plastikë, letër/karton, kanaçe, qelq).
3. Mbetje inerte (ndërtimi dhe prishjeje)
4. Mbetje bujqësore dhe organike

Diferencimi i mbetjeve bëhet në dy rryma në të riciklueshmet dhe mbetjet e pariciklueshme. Mbetjet e riciklueshme do të merren nga kompanitë e riciklimit dhe të pariciklueshmet do të dërgohen drejt incineratorit. Për realizimin e ndarjes do të ishte i nevojshëm një stacion magazinimi. Ky ishte pak a shumë prezantimi të cilin e gjeni edhe të publikuar në faqen zyrtare të bashkisë. Jemi të hapur për pyetje dhe diskutime.

Drejtor ekzekutiv i shoqatës ambjentaliste Zharrëza , z. Qani Rredhi- përshëndetje! Në



**Drejtor ekzekutiv i Shoqatës
z. Qani Rredhi**

**Dëgjesë publike me temë:
“Vlerësimi strategjik mjedisor mbi
Planin Lokal të Menaxhimit të
Integruar të Mbetjeve 2025-2030”**

Nëntor 2025

çdo bashki ka problematika me mbetjet? Cila është strategjia e bashkisë tuaj lidhur me këto mbetje?

Përfaqësues i qendrës për Nisma Qytetare për Mjedisin , z. Sajmir Dine- Bashkia vet, a ka parashikuar ndonjë zë në buxhet për përmirësimin e kushteve mjedisore, pasi përmendët magazinimin për kapacitete për riciklimin, ndotjen industriale? Çfarë plani ka bashkia lidhur me ndotjen në zonën naftëmbajtëse. A ka bashkia plan të investoj lidhur me këtë problem apo ndërhyrja duhet të vij nga kompania private?



**Përfaqësues i qendrës për Nisma
Qytetare për Mjedisin
z. Sajmir Dine**

Dëgjesë publike me temë:

**“Vlerësimi strategjik mjedisor mbi
Planin Lokal të Menaxhimit të
Integruar të Mbetjeve 2025-2030”**

Nëntor 2025

Kryetar i fshatit Siqec, z. Myftar Sorraj – përshëndetje të gjithëve! Faleminderit që na ftoni në dëgjesa të tilla publike. Në qoftë se ne nuk paguajmë taksat dhe kërkojmë shërbime kjo nuk ka kuptim. Së pari jam plotësisht dakord me planin, por te ne nuk ka kosh mbeturinash në Siqec. Aty hidhen mbeturinat në çdo vend. Ju lutem të vendosen koshat e mbeturinave në atë fshat.



**Përfaqësues i qendrës për Nisma
Qytetare për Mjedisin
z. Sajmir Dine**

**Dëgjesë publike me temë:
“Vlerësimi strategjik mjedisor mbi
Planin Lokal të Menaxhimit të
Integruar të Mbetjeve 2025-2030”**

Nëntor 2025



**Deputete
znj. Antoneta Dhima**

**Dëgjesë publike me temë:
“Vlerësimi strategjik mjedisor mbi
Planin Lokal të Menaxhimit të
Integruar të Mbetjeve 2025-2030”**

Nëntor 2025

bashkitë, por unë nuk shikoj se kush është grupi i punës që e ka hartuar këtë plan. Ajo që më bie në sy është përsëritja në material dhe a keni marrë parasysh në hartimin e këtij plani ligjin e ri të integruar të mbetjeve? Kjo pasi bashkitë kanë detyrime sipas neneve 18, 24, 26, 29 të këtij ligji. Numri i popullsisë vjen në ulje, kush është referenca që keni marrë parasysh lidhur me uljen e numrit të popullsisë? Sasia e mbetjeve që prodhohen dhe grumbullohen në territorin e bashkisë është të prodhuara 3848.19 dhe të grumbulluara 2919, që do të thotë norma e grumbullimit për të gjithë njësitë është 75.8% sipas raportit. Kjo diferenca midis mbetjeve nga vjen? Sipas përbërjes së mbetjeve që ju përcaktoni, në këto vlera që keni parashikuar janë përfshirë të gjitha kategoritë e mbetjeve? Nëse do të shikojmë prodhimin e mbetjeve nga 2024-2030 përsëri parashikohet me ulje. Pse ka ndodhur kjo ulje në prashikim? Një problem kryesor në menaxhimin e mbetjeve është edukimi, i cili fillon që në kopshte, shkolla, institucione arsimore dhe më qytetarë. Unë mendoj që duhet të ketë përfaqësues nga shkollat dhe kopshtet. Planet e mbetjeve janë detyrime ligjore jo vetëm për tu ndërtuar, por edhe për tu zbatuar.

Kryetar i bashkisë Patos, z. Fation Duro- Përshëndetje! Plani i mbetjeve është një pikë e rëndësishme për bashkinë tonë. Mbështetja për këtë plan ka ardhur nga Agjencia për



**Kryetar i bashkisë Patos
z. Fation Duro**

**Dëgjesë publike me temë:
“Vlerësimi strategjik mjedisor mbi Planin
Lokal të Menaxhimit të Integruar të
Mbetjeve 2025-2030”**

Nëntor 2025

Qeverisjen Vendore bashkë me ekspertët e tyre të nevojshëm. Ky plan është përshatur me nevojat e bashkisë tonë. Gjithë plani është bazuar në ligjin në fuqi dhe është e drejtë që normalisht që çdo gjë lind nga edukimi i shoqërisë dhe sidomos nga kopshtet dhe shkollat. Një pjesë të mirë në shkolla kemi vendosur koshat për ndarjen në burim me qëllim edukimin. Megjithatë dhe kjo mënyrë është një lloj sfide në vetvete pasi duhet të ketë kontroll. Kemi qëllim arritjen e një sistemi të mbetjeve më efikas dhe të kontrolluar. Në bazë të sasisë së mbetjeve nëse vazhdon me këtë ritëm do të jemi të detyruar të rrisin tarifën e pastrimit. Disa zona në lagje kanë pasur shumë problem me ndotjen dhe heqjen e mbetjeve. Unë mendoj që sa më i pastër të jetë qyteti aq më pak pis bëhet. Me këtë qëllim ne filluam me shpërndarjen e kontenierëve në disa lagje për çdo shtëpi për përdorim vetjak. Vitin tjetër kjo do të vazhdojë në të gjithë Patosin dhe njësinë administrative Zharrëz. Duke qënë se kostoja e mjeteve dhe punonjësve me këtë mënyrë mbledhjeje ul dhe kostot duke ofruar një shërbim akoma edhe më të mirë. Ndërsa një pjesë tjetër që është problem është pjesa e mbetjeve inerte, por edhe për këtë ne po mundohemi që ta sistemojmë, por duhen një sërë investimesh që duhen bërë në mënyrë të menjëhershme, pasi duhen mjete të nevojshme. Nëse llogarisim vlerën që çdo qytetarë paguan për të hequr inertet kur kryen punime në banesë do të shikojmë shpenzime të shtuara. Projektionet për numrin e popullsisë kanë ardhur duke u ulur dhe ne jemi të detyruar të bazohemi në të dhënat e Instat si burim i besuar. Lidhur me mjedisin ne jemi duke punuar pasi mbrojtja e mjedisit është e rëndësishme dhe ne bëjmë çdo vit monitorim të mjedisit në zonat për nxjerrjen e naftës dhe maten treguesit e tokës, ajrit, ujit. Ajo që mund të bëjmë është që në vitet e ardhshme kjo të shtohet dhe të bëhet më shpesh. Kjo lidhet dhe me çmimin e naftës në bursë. Nëse rritet kërkesa do të rritet dhe prodhimi. Kur çmimi naftës të rritet në këtë kohë duhet të bëjmë vlerësim të mjedisit. Ndërhyrja nga ana e bashkisë me mbjelljen e pemëve dhe mirëmbajtjen e tyre është e rëndësishme dhe është në proces që do të vazhdojë edhe në vitet e ardhshëm.

Drejtor ekzekutiv i shoqatës ambientaliste Zharrëza , z. Qani Rredhi - Ne aktualisht po vuajmë me grumbullimin e mbetjeve. Qeset me mbeturinat i varin në gardhe dhe hapen në



**Drejtor ekzekutiv i shoqatës ambientaliste
Zharrëza
z. Qani Rredhi**

**Dëgjесë publike me temë:
“Vlerësimi strategjik mjedisor mbi Planin
Lokal të Menaxhimit të Integruar të
Mbetjeve 2025-2030”**

Nëntor 2025

rrugë. Thatë që bëni monitorim mjedisi, por çfarë bëni me këto rezultate?

Kryetar i bashkisë Patos, z. Fation Duro- Lidhur me këtë pyetje duhet të shqyrtojmë



**Kryetar i bashkisë Patos
z. Fation Duro**

**Dëgjese publike me temë:
“Vlerësimi strategjik mjedisor mbi
Planin Lokal të Menaxhimit të
Integruar të Mbetjeve 2025-2030”**

Nëntor 2025

raportet e nxjerra dhe të sqarojmë. Dua të përmend pak pjesën e Ruzhdies, pasi pjesa e mbledhjes së mbetjeve lidhet edhe me infrastrukturën. Njësia Ruzhdie ka pasur probleme të theksuar me rrugët dhe kjo ka sjell problem edhe në menaxhimin e mbetjeve në këtë zonë. Nëse do të përmirësojmë edhe më shumë infrastrukturën do të jetë edhe më e lehtë menaxhimi. Jemi përpjekur me ndriçimin e zonës dhe vitin tjetër do të vazhdojmë ende edhe me përmirësimin e rrugëve duke krijuar lehtësi në akses.

Drejtore, z. Çajup Refitaj- Lidhur me pjesën e kompanive private dua të theksoj që kompanitë kanë leje mjedisore dhe kanë detyrim që të bëjnë një plan mbi ndikimin që kanë në mjedis. Për sa i përket mbetjeve që prodhojnë bëhet lidhja mbi marrjen e masave, nëse kalon lejen mjedisore. Jemi organ informues dhe kërkues për marrjen e masave dhe ne nga problematikat më të mëdha kemi këto mbetje që kanë detyrim kompanitë për të menaxhuar. Ne kemi detyrim ti monitojmë gjatë gjithë kohës dhe ti raportojmë nëse kalojnë lejen mjedisore.



**Drejtore
z. Çajup Refitaj**

**Dëgjese publike me temë:
“Vlerësimi strategjik mjedisor mbi
Planin Lokal të Menaxhimit të
Integruar të Mbetjeve 2025-2030”**

Nëntor 2025

Kryetar i fshatit Kuqar, z. Islam Shpata- Ne në fshat kemi pasur një problematik me rrugën dhe kjo na u realizua dhe ne ju jemi shumë falenderues mbi këtëinvestim. Kam një problem tjetër lidhur me mbetjet që hidhen në kosha kur pastrojnë inerte ose mbetje bujqësore. A ka ndonjë ligj që mund ti ndalojmë?



**Kryetar i fshatit Kuqar
z. Islam Shpata**

**Dëgjesë publike me temë:
“Vlerësimi strategjik mjedisor mbi
Planin Lokal të Menaxhimit të
Integruar të Mbetjeve 2025-2030”**

Nëntor 2025

Deputete, znj. Antoneta Dhima- Renta minerare si menaxhohet sepse me ligj ajo duhet të investohet vetëm në zonën që merret.



**Deputete
znj. Antoneta Dhima**

**Dëgjesë publike me temë:
“Vlerësimi strategjik mjedisor mbi
Planin Lokal të Menaxhimit të
Integruar të Mbetjeve 2025-2030”**

Nëntor 2025

Përfaqësues i qendrës për Nisma Qytetare për Mjedisin, z. Sajmir Dine- ju thatë që nuk



**Përfaqësues i qendres për Nisma
Qytetare për Mjedisin
z. Sajmir Dine**

**Dëgjesë publike me temë:
“Vlerësimi strategjik mjedisor mbi
Planin Lokal të Menaxhimit të
Integruar të Mbetjeve 2025-2030”**

Nëntor 2025

jemi bashki e pasur, ndërkohë që ne jemi jemi një nga zonat më të mëdha në Ballkan naftëmbajtëse. Si ndodh kjo?

Kryetar i bashkisë Patos, z. Fation Duro- Renta minerare ka një ndryshim dhe një rënie këtë vit. Kjo duke qënë se çmimi i naftës ka qënë në vlerë të ulët. Në total pjesa e investimeve për të gjitha bashkinë është 1.5 miliard lekë e planifikuar, por në fund aq sa ngelen. Plani me faktin jo gjithmonë përputhet. Pjesa e rentës investohet në zonat ku ka probleme apo nga ku ajo mblidhet. Më para në Patos ndjehej shumë era e naftës, por sot nuk është e njëjta situatë. Në zonën e Patosit janë bërë shumë ndryshime. Ka pasur lagje që nuk kanë patur asnjë rrugë kalimi dhe tani8 janë mundësuar. Edhe pjesa e Përroit çam është një investim shumë i madh, pasi ka qënë në gjendje shumë të keqe dhe shumë indotur, por tani ka ndryshim drastik.



**Kryetar i bashkisë Patos
z. Fation Duro**

**Dëgjesë publike me temë:
“Vlerësimi strategjik mjedisor mbi
Planin Lokal të Menaxhimit të
Integruar të Mbetjeve 2025-2030”**

Nëntor 2025

Anëtar i Këshillit Bashkiak, z. Artan Velçani- përshëndetje! Ky forum është i qartë. Nëse



**Anëtar i Këshillit Bashkiak
z. Artan Velçani**

**Dëgjesë publike me temë:
“Vlerësimi strategjik mjedisor mbi
Planin Lokal të Menaxhimit të
Integruar të Mbetjeve 2025-2030”**

Nëntor 2025

do kishim një forum për kritika do bënim shumë, por bashkia ka një qëllim të ndërtoj një plan dhe jemi shumë të qartë në prezantim. Bashkia ka një plan mbetjesh dhe kjo fillon që nga edukimi i brezave dhe deri te përcaktimi i vendeve përkatëse për ndarjen e mbetjeve. Strategjia jonë duhet të përputhet me strategjik përkatëse të qeverisë. Ne duhet të gjejmë mënyra për ndarjen organike të mbetjeve dhe strategjia juaj duhet të jetë më shumë

afatgjatde. Megjithatë bashkia ka instrumenta ligjor jo për të detyruar, por për të orientuar edhe industrit e mëdha të naftës. E vlerësoj shëndetshëm këtë dëgjese dhe dhënien e opinioneve në këtë dëgjese.

Përfaqësues i qendrës për Nisma Qytetare për Mjedisin, z. Sajmir Dine- Kur të bëhet ndarja në burim i mbetjeve, a do të ketë bashkia ndonjë politikë për taksën e pastrim gjelbërimit?



**Përfaqësues i qendrës për Nisma
Qytetare për Mjedisin
z. Sajmir Dine**
Dëgjese publike me temë:
**“Vlerësimi strategjik mjedisor mbi
Planin Lokal të Menaxhimit të
Integruar të Mbetjeve 2025-2030”**

Nëntor 2025

Kryetar i bashkisë Patos, z. Fation Duro- Ndarja mund të bëhet në tre ose dy kontenier dhe



**Kryetar i bashkisë Patos
z. Fation Duro**
Dëgjese publike me temë:
**“Vlerësimi strategjik mjedisor mbi
Planin Lokal të Menaxhimit të
Integruar të Mbetjeve 2025-2030”**

Nëntor 2025

te pjesa e kostos arritja më e madhe do të jetë që në qoftë se ne do të duam të ruajmë taksën e pandryshuar atëherë do duhet të ndërhyrjmë në mënyrën e mbledhjes së mbetjeve duke ulur kostot për mbledhjen.

Kryetar i fshatit Zharrëz, z. Bexhet Rredhi- Kemi problem me ujërat e zeza në fshat. Gjithashtu për çështjen e mbetjet bimore dhe ato të serave, ku do të shkojnë dhe ku duhet ti hedhim?



**Kryetar i fshatit Zharrëz
z. Bexhet Rredhi**

**Dëgjësë publike me temë:
“Vlerësimi strategjik mjedisor mbi
Planin Lokal të Menaxhimit të
Integruar të Mbetjeve 2025-2030”**

Nëntor 2025

Kryetar i bashkisë Patos, z. Fation Duro- Lidhur me mbetjet besoj do të bëjmë një stacion kompostimi që të përdoret për këto mbetje.



**Kryetar i bashkisë Patos
z. Fation Duro**

**Dëgjësë publike me temë:
“Vlerësimi strategjik mjedisor mbi Planin
Lokal të Menaxhimit të Integruar të
Mbetjeve 2025-2030”**

Nëntor 2025

Kryetar i Këshillit Bashkiak, z. Armand Ahmetaj- Nëse nuk keni rekomandime dhe



**Kryetar i Këshillit Bashkiak,
z. Armand Ahmetaj**

**Dëgjësë publike me temë:
“Vlerësimi strategjik mjedisor mbi
Planin Lokal të Menaxhimit të
Integruar të Mbetjeve 2025-2030”**

Nëntor 2025

komente të tjera lidhur me dokumentin atëherë unë e deklaroj të mbyllur këtë dëgjësë publike duke ju falenderuar për pjesëmarrjen tuaj.

Sekretar i Këshillit

Refaela Xeba

Koordinator i Konsultimit Publik

Simela Shahinaj